



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) NR. 11/2023 PËR KRITERET
TEKNIKE PËR IMPORT, DEPONIM, SHITJE ME SHUMICË DHE
PAKICË TË KARBURANTEVE TË RIPËRTËRITSHME TË NAFTËS ,
DHE PASTRIM TË REZERVUARVE**

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nenin 17 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/I-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme, nenin 11 paragrafi 1.3. të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Shtojca 12 e Rregullores Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 11/2023

PËR KRITERET TEKNIKE PËR IMPORT, DEPONIM, SHITJE ME SHUMICË DHE PAKICË TË KARBURANTEVE TË RIPËRTËRITSHME TË NAFTËS , DHE PASTRIM TË REZERVUARVE

Neni 1 Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kriteret teknike-teknologjike për subjektet që merren me import, deponim, shitje me shumicë, ose me pakicë të karburanteve të naftës dhe atyre të ripërtërishme dhe import te lëndës së parë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve të naftës, pastrimin e rezervuarve.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për subjektet që merren me veprimtarit me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme, të cilët përpos zbatimit të kriterëve të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ duhet të plotësojnë edhe kritere tjera të përcaktuara me aktet normative përkatëse.

Neni 3 Përkufizim

Termet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ e kanë kuptimin e njëjtë sikurse në Ligjin përkatës për produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme.

Neni 4

Kriteret teknike për deponim të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtërishme

1. Për deponim të karburanteve siç janë: dizeli, benzina, karburanti në fushën e aviacionit, (karburanti Jet), gazoili dhe vajguri, përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera përkatëse, subjekti duhet t'i plotësojë edhe këto kriterë për deponim:

- 1.1 Për secilin karburant të ketë rezervuar për deponim që është prodhuar në pajtim me rregullat dhe kriteret tjera specifike për produktet përkatëse;
- 1.2. Të posedojë peshore që mundëson matje nga zero deri në 60 ton me klasë saktësie III dhe me periudhë të vlefshme të verifikimit apo të posedojë instrumente në rrjedhje për mbushje të autoboteve me kalibrim të vlefshëm nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës;
- 1.3. Deponia duhet të jetë e rrethuar me rrethojë;
- 1.4. Deponia duhet të jetë e monitoruar;
- 1.5. Rezervuarët brenda deponisë duhet të kenë argjinaturë mbrojtëse që në rast të derdhjes së mundshme për të mbajtur tërë kapacitetin e secilit rezervuar dhe 70% të kapacitetit të përgjithshëm të rezervuarëve në rastet kur argjinatura është e përbashkët për dy apo më tepër rezervuarë;
- 1.6. Të ketë të instaluar sistemin e ftohjes për rezervuarët mbitokësor si dhe sistemin e shuarjes së zjarrit me ujë dhe shkumë;
- 1.7. Të posedojë kapacitete deponuese të ujit për ftohje të rezervuarëve dhe shuarje të zjarrit;
- 1.8. Të posedojë kolektorët dhe seperatorët;
- 1.9. Dëshmia e pastrimit të rezervuarëve nga një subjekt i autorizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 5

Kriteret teknike për deponim të GLN-së

1. Për deponim të GLN-së, përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera, subjekti duhet t'i plotësojë edhe këto kriterë për deponim:

- 1.1. Të ketë rezervuar për deponim që është prodhuar në pajtim me rregullat teknike;
- 1.2 Të ketë peshore që mundëson matje nga zero deri ne 60 ton me klasë saktësie III dhe me periudhë të vlefshme të verifikimit apo të posedojë instrumente matëse për mbushje të autoboteve me kalibrim të vlefshëm nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës;
- 1.3 Deponia duhet të jetë e rrethuar me rrethojë;
- 1.4 Deponia duhet të jetë e monitoruar;
- 1.5 Të ketë të instaluar sistemin e ftohjes për rezervuarët mbitokësor si dhe sistemin e shuarjes së zjarrit me ujë dhe shkumë;
- 1.6 Të posedojë kapacitete deponuese të ujit për ftohje të rezervuarëve dhe shuarje të zjarrit;
- 1.7. Të posedojë kolektorët dhe sensor për detektimin e rrjedhjes së gazit.

Neni 6

Kriteret teknike për deponim të bombolave me GLN të amvisërisë

1. Për deponim të bombolave me GLN të amvisërisë (njëpërdorimshme) përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera subjekti duhet t'i plotësoj edhe këto kriterë për deponim:

- 1.1. Hapësira e veçantë të jetë mbi 100 metra katror dhe e destinuar vetëm për bombola të GLN-së;
- 1.2. Të posedojë aparate kundër zjarrit dhe nyje sanitare;
- 1.3. Të mos jetë e ekspozuar ndikimit të rrezeve të diellit dhe burimeve tjera, të jetë e ajrosur mirë.

Neni 7

Kriteret teknike për deponim të vajrave të rënda për nxemje

1. Për deponim të vajrave të rënda për nxemje përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera, subjekti duhet t'i plotësoj edhe këto kriterë për deponim:

- 1.1. Për secilin produkt të posedojë rezervuar për deponim që është prodhuar në pajtim me rregullat teknike;
- 1.2. Deponia duhet të jetë e rrethuar me rrethojë;
- 1.3. Deponia duhet të jetë e monitoruar;
- 1.4 Të këtë të instaluar sistemin e shuarjes së zjarrit me ujë dhe shkumë;
- 1.5. Të këtë të instaluar për rezervuarët mbitokësor sistemin e ngrohjes dhe mbështjelljen termoizoluese për vajrat e rënda të cilat ngurtësohen në temperaturë të ambientit ;
- 1.6. Të posedojë kapacitete deponuese të ujit për ftohje të rezervuarëve dhe shuarje të zjarrit;
- 1.7. Rezervuarët brenda deponisë duhet të kenë argjinaturë mbrojtëse që në rast të derdhjes së mundshme për të mbajtur tërë kapacitetin e secilit rezervuar dhe të 70% të kapacitetit të përgjithshëm të rezervuarëve në rastet kur argjinatura është e përbashkët për dy apo me tepër rezervuarë;
- 1.8 Të posedojë kolektorët dhe seperatorët;
- 1.9. Dëshmia e pastrimit të rezervuarëve nga një subjekt i autorizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 8

Kriteret teknike për deponim të koksit të naftës dhe të produkteve tjera për qëllime të djegies

1. Për deponim të koksit të naftës dhe të produkteve tjera për qëllime të djegies, përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera subjekti duhet t'i plotësoj edhe këto kriterë për deponim:

- 1.1. Të këtë hapësire/vend shkarkim adekuat mbi 100 metra;
- 1.2. Deponia duhet të jetë e rrethuar me rrethojë;
- 1.3. Të posedojë aparate kundër zjarrit dhe nyje sanitare.

Neni 9

Kriteret teknike për deponim dhe shitje të produkteve të caktuara të vajrave për qëllime tjera

1. Për deponim dhe shitje të produkteve të caktuara të vajrave për qëllime tjera, përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera subjekti duhet t'i plotësoj edhe këto kriterë për deponim:

- 1.1. Hapësira e veçantë të jetë mbi 100 metra katror dhe e destinuar për vajra motorike dhe lubrifikant;
- 1.2. Të posedojë aparate kundër zjarrit dhe nyje sanitare;
- 1.3. Të mos jetë i ekspozuar burimit të nxehtësisë;
- 1.4. Të ketë kolektor dhe separator.

Neni 10

Kriteret teknike për deponim dhe import të lëndës së parë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve të naftës

1. Për deponim dhe import të lëndës së parë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve të naftës përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera subjekti duhet t'i plotësoj edhe këto kriterë për deponim:

- 1.1. Për secilin karburant të ketë rezervuar për deponim që është prodhuar në pajtim me rregullat dhe kriteret tjera specifike për produktet përkatëse;
- 1.2. Të posedojë peshore që mundëson matje nga zero deri në 60 ton me klasë saktësie III dhe me periudhë të vlefshme të verifikimit apo të posedojë instrumente në rrjedhje për mbushje të autoboteve me kalibrim të vlefshëm nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës;
- 1.3. Deponia duhet të jetë e rrethuar me rrethojë;
- 1.4. Deponia duhet të jetë e monitoruar;
- 1.5. Rezervuarët brenda deponisë duhet të kenë argjinaturë mbrojtëse që në rast të derdhjes së mundshme për të mbajtur tërë kapacitetin e secilit rezervuar dhe 70% të kapacitetit të përgjithshëm të rezervuarëve në rastet kur argjinatura është e përbashkët për dy apo më tepër rezervuarë;
- 1.6. Të ketë të instaluar sistemin e ftohjes për rezervuarët mbitokësor si dhe sistemin e shuarjes së zjarrit me ujë dhe shkumë;
- 1.7. Të posedojë kapacitete deponuese të ujit për ftohje të rezervuarëve dhe shuarje të zjarrit;
- 1.8. Të posedojë kolektorët dhe seperatorët
- 1.9. Të posedojë skemën teknologjike të impianteve për përpunim-prodhim;
- 1.10. Dëshmia e pastrimit të rezervuarëve nga një subjekt i autorizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 11

1. Subjektet që kanë deponitë sipas nenit 4 deri te neni 10 të këtij udhëzimi administrativ, nuk u lejohet shitja me pakicë të karburanteve në lokacionet e deponive.

2. Depoja duhet të ketë mbishkrimet për rrezikun.

3. Subjektet që kanë deponitë janë të obliguar që rezervuarët dhe pajisjet të kontrollojnë për gjendjen teknike të tyre dhe për këtë duhet të mbajnë evidencë.

Neni 12

Kriteret teknike për shitje me pakicë të naftës dhe karburanteve të ripërtërishme

1. Për shitje me pakicë të dizelit, benzinës përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera pika e karburanteve duhet t'i plotësoj edhe këto kriterë:

- 1.1 Pajisjet për mbushje duhet të jenë të mbuluara;
- 1.2 Aparati për mbushje që nuk është funksional duhet të jetë i shënuar me mbishkrimin “Aparati është jashtë funksionit”;
- 1.3 Pika shitëse duhet të ketë rezervuarë për secilin karburant, të prodhuar në pajtim me rregullat teknike Rezervuarët mbitokësor duhet të posedojnë argjinature betonarme, me kapacitet 110% të përgjithshëm të rezervuarit. Të ketë sistem të ftohjes me ujë. Të jete i mbrojtur nga mjetet e transportit ;
- 1.4. Rezervuarët duhet të jenë të siguruar me kapak i cili pamundëson hyrjen e ujit dhe të mbeturinave në karburante;
- 1.5. Në kapakun e rezervuarit duhet të jetë i shënuar lloji i karburantit;
- 1.6. Të posedojë thuprën metalike për matjen e nivelit të produktit të naftës në rezervuar, me kokë të punuar nga legura e bakrit;
- 1.7. Të posedojë gropë septike ose seperator, të lidhur me kolektorë për të grumbulluar derdhjet e padëshirueshme;
- 1.8. Të posedojë aparate mobile për shuarje të zjarrit me afat të verifikimit të vlefshëm;
- 1.9. Rezervuarët duhet të kenë ventilim të jashtëm;
- 1.10. Të posedojë nyje sanitare dhe stabilimente higjienike;
- 1.11. Dëshmia e pastrimit të rezervarëve nga një subjekt i autorizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

2. Për shitje me pakicë të GLN-së për Automjete, përveç kriterëve të përcaktuara me akte normative tjera subjekti duhet t'i plotësoj edhe këto kriterë:

- 2.1. Të ketë rezervuar nëntokësore ose mbitokësor të prodhuar në pajtim me rregullat teknike. Rezervuarët nuk mund të vendosen nën rrugë publike, hekurudhë, e as brenda apo nën objekte fikse.

3. Pika shitëse duhet të ketë mbishkrimet për rrezikun.

4. Subjekti është i obliguar që rezervuarët dhe pajisjet të kontrollojnë për gjendjen teknike të tyre dhe për këtë duhet të mbajnë evidencë.

Neni 13

Kriteret teknike për pastrimin e rezervuarve

1. Obligohen subjektet që merren me veprimtarit me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme që me rastin e licencimit, dëshminë për pastrim të rezervuarve të dorezojnë tek Komisioni për Verifikimin e Kriteve Teknike. Pastrimi bëhet në kuadër të standardit, SK EN ISO 14001:2018 (Sistemet e menaxhimit të mjedisit). Kërkesat me udhëzim për përdorimin e tij. Në raste të ndryshimeve të standardit, vlejné standardet ne fuqi ose ekuivalenti i tyre.
2. Dëshmia për pastrimin e rezervuarve nuk duhet të jetë më e vjetër se 4 (katër muaj) nga data e aplikimit për licencim.
3. Kompanitë të cilat bëjnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e rezervuarve të karburanteve të lëngëta të naftës duhet të jenë të autorizuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 14

Procedura e aplikimit

Njoftimi për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë dhe shërbimet e pastrimit të rezervuarve bëhet nga DRRTN përmes shpalljes publike në afat prej 15 ditë pune, në web faqen e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në media elektronike apo të shkruara.

Neni 15

Kërkesa për autorizim

1. Subjektet që aplikojnë për autorizim nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë duhet të plotësojnë paraprakisht kriteret si në vijim:
 - 1.1. Certifikatën e ARBK-së me kode përkatëse;
 - 1.2. Pëlqimin mjedisor të lëshuar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - 1.3. Autobotin special (makina) e dedikuar për këtë veprimtari;
 - 1.4. Të posedoj Impiantin e licencuar ose të kontraktuar me ndonjë impiant të licencuar, nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për trajtimin (grumbullimin) dhe asgjësimin e mbetjeve për trajtimin dhe grumbullimin e mbetjeve nga pastrimi i rezervuarve;
 - 1.5. Ekipin e trajnuar apo certifikuar për pastrimin e rezervuarve mbitokësor dhe nëntokësor të tipit horizontal dhe vertikal, dhe Ekspert të fushës për kontrole të gjendjes teknike të rezervuarve;
 - 1.6. Pajisjet e veçanta për stafin operues: maskat, bocat e oksigjenit, rrobat kundër zjarrit, aparati për matjen e gazrave;
 - 1.7 Ventilatorin për shkarkimin e gazrave;
 - 1.8. Siguria në punë për hapësira të mbyllura sipas standardit 45001-Mbi menaxhimin e mbrojtjes dhe shëndetit në punë. Në raste të ndryshimeve të standardit, vlejné standardet ne fuqi ose ekuivalenti i tyre.

Neni 16
Komisioni Vlerësues

1. Kërkesa për autorizim vlerësohet nga komisioni profesional i themeluar me vendim të Ministrit, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve.
2. Një (1) anëtar duhet të jetë i departamentit të naftës, ndërsa (4) anëtarët tjerë emërohen nga Ministria.
3. Anëtarët kanë mandat 2 (dy) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat.
4. Komisioni vlerësues në afat prej 30 (tridhjetë) ditë pune vlerëson dhe shqyrton aplikacionet dhe vendos nëse subjektet që aplikojnë për autorizim i plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas nenit 15 të këtij Udhëzimi.
5. Raporti përfundimtar me rekomandim të komisionit për Ministrin, duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues.

Neni 17
Verifikimi i përmbushjes së kriterëve

1. Komisioni gjatë procedurës së vlerësimit dhe shqyrtimit mund të kërkojë nga Aplikuesi dokumente plotësuese që duhet të dorëzohen në afat prej jo më shumë se pesë (5) ditë pune.
2. Gjatë shqyrtimit të aplikacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar, komisioni me qëllim të vërtetimit të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në nenin 14 të këtij Udhëzimi, duhet të bëjë kontrolle tek aplikuesi.

Neni 18
Afatshmëria e Autorizimit

Subjektet autorizohen në afat prej 2 vite, me mundësi vazhdimi.

Neni 19
Miratimi i kërkesave

1. Ministria nxjerr vendim në bazë të rekomandimit të Komisionit vlerësues për miratimin, refuzimin, për autorizimin e subjektit që ushtron këtë veprimtari.
2. Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni është akt administrativ përfundimtar në kuptim të ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

Neni 20
Revokimi i autorizimit
për ushtrimin e veprimtarisë

1. Procedura për revokimin e autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë mund të iniciohet në rastet kur subjekti i autorizuar pushon së përmbushuri kriteret e autorizimit.
2. Revokimi i autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë mund të iniciohet mbi bazën e inspektimit nga inspektorati i tregut, nëse shkeljet konstatohen nga inspektorati i tregut.
3. Departamenti për rregullimin e tregut të naftës, i propozon Ministrin për revokimin apo pezullimin e autorizimit të subjektit që ushtron këtë veprimtari, në bazë të raportit të inspektoratit të tregut.

Neni 21
Gjykata

Ndaj vendimit të Ministrin lejohet padi në gjykatë sipas ligjit përkatës për konfliktet administrative.

Neni 22
Mbikëqyrja inspektuese

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ mbikëqyren nga Inspektorati i tregut, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 23
Dispozitat kalimtare

Dëshmia e pastrimit të rezervarëve nga një subjekt i autorizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e përcaktuar në nenin 4 nën paragrafi 1.9, në nenin 7 nën paragrafi 1.9, në nenin 10 nën paragrafi 1.10, në nenin 12 nën paragrafi 1.11, nuk do të zbatohet si kriter, derisa të autorizohen subjektet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 24
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohen Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2019 Për përmbushjen e kushteve teknike nga subjektet që merren me importin, deponimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të karburanteve dhe Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 2007/18 “Për kërkesat teknike për ndërtimin dhe funksionimin e pikave për furnizimin e automjeteve me karburante.

Neni 25
Hyrja ne fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 17.11.2023

Rozeta HAJDARI

Ministre